



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19. 01. 2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 12 dhe 18 nëntor 2021.

2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit nga data 17 janar – 4 shkurt 2022, si dhe të programit të punës së komisionit nga data 17 janar – 25 shkurt 2022.

3. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të vitit 1957”.

4. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri””.

5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe (KfW) për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Bardhyl Kollçaku, Tomorr Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku, Benet Beci dhe Vangjel Dule.

Mungojnë:

Alqi Bllako, Tritan Shehu, Grida Duma dhe Shpëtim Idrizi.

Të ftuar:

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të
Legjislacionit

Ilir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Ardian Islami – Drejtor i Projekteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile - Drejtor në OSHEE

Kesjana Halili - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe
Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e parë të Komisionit për Politikën e Jashtme për këtë sesion parlamentar, datë 19.01.2022.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 12 dhe 18 nëntor 2021.

Pika e dytë është miratimi i kalendarit të punës së komisionit nga data 17 janar - 4 shkurt 2022, si dhe miratimi i programit të punës së komisionit nga data 17 janar – 25 shkurt 2022.

Duke i uruar komisionit punë dhe vit të mbarë, fillojmë diskutimin për projektligjet që kemi sot në rendin e ditës.

Projektligji i parë është ai “Për ratifikim e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të vitit 1957”. Relator i këtij projektligji është kolegu Koçi, kurse ne jemi komision për dhënie mendimi.

Më pas do të vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, (huamarrësi) përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”. Për këtë projektligj jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator është kolegu Ajazi.

Gjithashtu, kemi për diskutim edhe projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri””. Ky projektligj ka ardhur me procedurë të përshpejtuar. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator është kolegu Beci.

Nëse jeni dakord me procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të datave 12 dhe 18 nëntor 2021, i konsideroj ato të miratuara. Gjithashtu, për sa i përket kalendarit dhe programit të punës së komisionit për datat respektive, 17 janar-4 shkurt dhe 17 janar- 25 shkurt, nëse nuk ka kundërshtime apo propozime të tjera, i konsideroj të miratuara.

Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit “Për ratifikim e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës”.

Të ftuar kemi zonjë Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë, si dhe zotin Beja, drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Mirë se keni ardhur!

Ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të marrëveshjes!

Fjala për ju, zonja zëvendësministre!

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot ju paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikim e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të vitit 1957”. Kjo marrëveshje synon të intensifikojë nivelin e bashkëpunimit efektiv ndërkombëtar në fushën penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës përmes lehtësimit të procedurave të ekstradimit të shtetasve ndërmjet dy vendeve.

Dua të sjell në vëmendjen e anëtarëve të nderuar të këtij komisioni se Konventa Europiane për Ekstradimin, e cila është ratifikuar me ligjin nr.8322, datë 02.04.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë”, parashikon shprehimisht në nenin 28 të saj se palët nënshkruese të kësaj konvente mund të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me qëllim plotësimin e parashikimeve të kësaj konvente ose lehtësimin e zbatimit të saj. Mbi këtë bazë, projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje parashikon se palët bien dakord të ekstradojnë reciprokisht shtetasit e tyre, me qëllim ekzekutimin e një dënimi ose zbatimin e një mase sigurimi në përputhje me dispozitat e konventës në fjalë.

Në nenin 6, pika 1, shkronja “a”, të kësaj konvente parashikohet shprehimisht se çdo palë ka të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të saj. Megjithatë, në nenin 2, të ligjit nr. 8322 për ratifikimin e kësaj konvente, parashikohet se për nenin 6 të konventës, pika 1, shkronja “a”, pala shqiptare mund të vendosë refuzimin e ekstradimit të shtetasve të saj, me përjashtim të rasteve kur në marrëveshje parashikohet ndryshe. Konkretisht, mbi këtë bazë ligjore krijohet mundësia për t’i hapur rrugë mundësisë së ekstradimit të shtetasve shqiptarë, si dhe ekstradimit të shtetasve të shteteve të tjera në Shqipëri, nëse parashikohet shprehimisht në një marrëveshje.

Konkretisht, përmes kësaj marrëveshjeje mundësohet ekstradimi i shtetasve spanjollë në Shqipëri dhe anasjelltas. Në këtë kuadër, synohet, gjithashtu, ruajtja dhe forcimi i lidhjeve mes dy sistemeve të drejtësisë, si dhe përmirësimi i institutit të ekstradimit për dorëzimin

reciprok të autorëve të veprave penale ose personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekja penale ose ndaj të cilëve do të zbatohet një masë sigurimi.

Kjo marrëveshje është një garanci e shtuar për marrëdhëniet juridiksionale në fushën penale me Spanjën, duke parashikuar lejimin e ekstradimit të shtetasve të vet për secilin nga shtetet palë të kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje ka kaluar nëpërmjet të gjitha fazave të parashikuara në legjislacionin “Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 560, datë 29.09.2021 dhe është nënshkruar në datën 4 tetor në Madrid nga Kryeministrat e të dyja vendeve.

Kjo marrëveshje nuk parashikon nevoja buxhetore shtesë, pasi rregullon procedurat që ndiqen gjatë një kërkesë për ekstradim. Kostot eventuale të procesit të ekstradimit do të përballohen brenda tavaneve buxhetore të secilit prej institucioneve, të cilët kanë funksione të përcaktuara në procesin e ekstradimit.

Sipas parashikimeve të nenit 24 të Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin, secila prej palëve mbulon çdo shpenzim që kryhet në territorin e palës së kërkuar për shkak të një kërkesë për ekstradim, ndërsa shpenzimet e tranzitit mbulojnë nga pala kërkuese.

Megjithatë, në këtë rast vlen të theksohet se është e vështirë të parashikohet apriori tërësia e kostove që do të duhet të mbulojnë institucionet e përfshira në këtë proces, përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë ose institucionet e tjera ligjzbatuese. Gjithashtu, është e vështirë të parashikohet edhe kohëzgjatja e një procesi ekstradimi, duke qenë se do të duhet të kalohen të gjitha hallkat e parashikuara nga ligji.

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror kompetent për zbatimin e Konventës Europiane për Ekstradimin dhe marrëveshjeve dypalëshe për ekstradimin ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale midis Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë. Që prej vitit 2017 kjo ministri ka përpunuar rreth 92 letërporosi hyrëse dhe dalëse, 25 kërkesa për ekstradim nga Spanja, si dhe 3 kërkesa për ekstradim nga autoritetet shqiptare drejtuar Spanjës.

Natyrisht, vullneti për të nënshkruar këtë marrëveshje është shprehje e qartë e besimit që kanë partnerët tanë ndërkombëtarë, në rastin konkret Mbretëria e Spanjës, për të na konsideruar si partner të besueshëm në kuadër të luftës për krimin trans-nacional.

Në përfundim të kësaj ekspozije mbi përmbajtjen, qëllimin dhe procedurën e ndjekur për këtë marrëveshje, dua t’ju them se mbetemi në dispozicion të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni për të dhënë shpjegime për dispozita të veçanta të kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Fjala për zotin Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Konventa Europiane për Ekstradimin, në të cilën ne jemi palë, pengon dhe nuk detyron palët të bëjnë ekstradime kriminelësh në vendet reciproke, në këtë rast mes Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, por kjo marrëveshje e tejkalon pengesën që parashikohet në nenin 6, pika 1, shkronja “a”, të kësaj konvente.

Sigurisht, është një investim i mëtejshëm i Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës në fushën e bashkëpunimit penal, por edhe në luftën ndaj krimit në përgjithësi, sepse është për dorëzimin e kriminelëve që mund të jenë shtetas shqiptarë apo spanjollë.

Të dhënat dëshmojnë se ka një rritje të kriminalitetit shqiptar në Spanjë. Mendoj se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje tregon edhe një herë vullnetin e qeverisë shqiptare për të luftuar krimin në përgjithësi dhe krimin që transferohet edhe në vendet e tjera, sidomos në vendet e Bashkimit Europian.

Gjithashtu, mendoj se kjo marrëveshje do të marrë mbështetjen konsensuale të këtij komisioni dhe më pas të parlamentit, sepse ajo tregon vullnetin e Republikës së Shqipërisë për të luftuar kriminalitetin me origjinë shqiptare edhe kur ai shtrihet në vende të tjera.

Sigurisht që këtu parashikohet edhe ekstradimi i shtetasve spanjollë që mund të jenë rezidentë të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, nëse ata kanë kryer veprimtari kriminale, po themi, në Spanjë apo edhe shtetas spanjollë që mund të kenë kryer krime në dëm të Republikës së Shqipërisë dhe që gjenden në Spanjë e kështu me radhë.

Kështu që mendoj se duhet mbështetur nga i gjithë komisioni.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje ose komente?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Kam unë një pyetje.

Marrëveshja parashikon që nuk zbatohen automatikisht kërkesat për ekstradime para se të hyjë në fuqi kjo marrëveshje. Ndërsa për veprat penale, pavarësisht se kur janë kryer, marrëveshja, po themi, funksion, ka fuqi. Po në rast se kërkesa për ekstradim përsëritet? Pra, një kërkesë e vjetër, e cila nuk mund të zbatohet me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje? Po në rast se ajo, po themi, përsëritet nga njëra prej palëve? Besoj se funksionon, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Po, zonja zëvendësministre.

Adea Pirdeni – Faleminderit, i nderuar deputet!

Në lidhje me këtë çështje, natyrisht, kriteri i vendosur në marrëveshje lidhur me kohën përcakton kohën kur është dërguar kërkesa për ekstradim. Do të thotë që në momentin kur kërkesa e dërguar për ekstradim është kërkuar përpara lidhjes së kësaj marrëveshjeje, nuk mund të merret në konsideratë, por, në momentin që riparaqitet pasi kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi, do të thotë se, pasi është ratifikuar nga të dy parlamentet e vendeve anëtare, natyrisht që do të merret në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Keni koment?

Po, zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Zonja kryetare dhe kolegë,

Patjetër që, dhe personalisht e mendoj, nuk ka asnjë argument për ta kundërshtuar marrëveshjen, por është për t'u mbështetur, pasi vjen në kuadrin e një harmonizimi të përpjekjeve me partnerët tanë në luftën kundër krimit apo elementëve të tij. Por, përveç mbështetjes sime, dhe nuk po zgjatem te kjo, përderisa situata ndodhet e njëjtë, unë nuk do të lodhem duke ripërsëritur që do të doja shumë që ne të mblidhemi jo vetëm për të folur për ata individë, pjesë të komunitetit shqiptar në të gjithë botën, që, okej, ushtrojnë aktivitete të tilla dhe nevojitet bashkëpunimi me disa standarde, por do të doja që këtu të mblidheshim edhe për të diskutuar për ato çështje që mund t'i lehtësojnë njerëzit tanë që janë andej. Pra, do të duhet të ishte jo vetëm ky komision, por në tërësi të gjitha institucionet e këtij vendi më afër nevojave të emigracionit dhe diasporës sonë në botë.

Përveç rasteve kriminale, ka shumë njerëz që duan të investojnë, që duan të bëjnë jetë normale, që kanë vështirësi në vende të caktuara. Ndaj do të doja që Ministria jonë e Jashtme, diplomacia jonë, të ishte më proaktive në hulumtimin e këtyre kërkesave, në përpjekjet e shtetit shqiptar, në mbështetjen sado të mundet dhe me marrëveshje të tilla, pra në mbështetjen të njerëzve jo vetëm në raste të tilla ekstreme.

Besoj që është momenti që këtë të mos e lëmë në retorikë.

Unë pata fatin para disa ditësh të takohesha me një grup deputetësh nga parlamenti i Kosovës, ku e shtrova këtë çështje. Ka një vullnet për të bashkërenduar përpjekjet e të dyja parlamenteve, e këtyre dy institucioneve në ndarjen e eksperiencave apo në hulumtimin e hapësirave, ku ne mund t'i mbështesim njerëzit tanë në botë dhe të mos mblidhemi këtu e të flasim gjithmonë për kriminelë që duhen ekstraduar apo raste të tjera të tilla, që, patjetër, janë në logjikë normale reagimi. Por që situata të mos ngelë rutinë, duhet që edhe ne të lëvizim në

mbështetjen apo në hulumtimin e hapësirave që kanë strukturat tona shtetërore, diplomacia jonë, në mbështetje të njerëzve që janë ata të të gjitha natyrave, qoftë atyre personale, qoftë atyre të investimeve; të çdo lloj forme.

Ky ishte një lloj apeli, përveç mbështetjes sime për marrëveshjen.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Çollaku!

Unë mendoj që i kemi të gjitha mundësitë dhe mjetet për ta bërë këtë gjë.

E kemi folur disa herë në parim dhe kemi rënë të gjithë dakord që ne si Komision i Politikës së Jashtme mund dhe duhet të bëjmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të propozojmë incentiva apo të kemi iniciativa, të cilat shkojnë në këtë drejtim.

Unë mendoj që ka disa rrugë për ta bërë këtë gjë dhe, pa dyshim, një ndër to është njohja me eksperiencat e tjera, të ngjashme me tonat.

Një rrugë tjetër është intensifikimi i marrëdhënieve midis parlamenteve apo komisioneve tona dhe komisioneve të vendeve respektive, ku ne jemi të interesuar apo ku ka në shumicë dominante qytetarë shqiptarë.

Unë besoj se qytetarët shqiptarë sot përballen me disa nevoja që kërkojnë zgjidhje, ashtu siç ishte çështja e njohjes së viteve të punës për shkak të sigurimeve shoqërore, që lidhen me vitet e punës në vende të ndryshme, pra atje ku banojnë dhe atje ku kanë banuar, dhe kjo është një gjë e cila tashmë po finalizohet me Italinë, që është një arritje shumë e madhe. Më shumë se gjysmë milioni i shqiptarëve që banojnë atje do t'u njihen vitet respektive të punës në të dyja vendet. Kam idenë se ka nevojë që kjo të mund të zgjerohet si në Francë, si në Spanjë, si në Britani, si në Gjermani, si në Greqi, atje ku, në fakt, ka shumicë shqiptarësh.

Nga ana tjetër, mund të shikojmë mundësinë e lehtësimit të presionit të taksimit të atyre qytetarëve shqiptarë që banojnë në vende të tjera dhe që kanë nevojë dhe duan të investojnë në Shqipëri. Këtë ne mund ta bëjmë fare mirë, duke penetruar në të gjithë legjislacionin tonë dhe të mund të realizojmë propozime konkrete. Kështu, besoj se mund të realizojmë një takim informal me njëri-tjetrin dhe të mund të shikojmë cilat janë prioritetet e qytetarëve shqiptarë të diasporës dhe mundësitë që ne kemi për të incentivuar lehtësimin e jetës së tyre atje nëpërmjet propozimeve tona.

Kështu që, kur të doni, mund të lëmë një takim, qoftë edhe pas kësaj mbledhjeje të parë dhe mund të shikojmë, të diskutojmë se çfarë mund të bëjmë.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Mimi Kodheli – Asgjë. Të lutem!

Mirë, e hedhim në votim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E konsideroj të miratuar. Të gjithë e aprovojnë.

E hedhim edhe në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

E konsideroj të miratuar, pasi nuk ka votë kundër dhe asnjë abstenim.

Zonja zëvendësministre, zoti drejtor, ju falënderoj për prezencën dhe ju uroj punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.01.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Bardhyl Kollçaku, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdim Krashi, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku, Benet Beci dhe Vangjel Dule

Mungojnë:

Alqi Bllako, Tritan Shehu, Grida Duma dhe Shpëtim Idrizi

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ardian Islami – Drejtor i Projekteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ilda Malile – Drejtoreshë në OSHEE.

Kesjana Halili – Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Mimi Kodheli – Presim të vijnë të ftuarit e tjerë.

Ndërkohë, në diskutim kemi, po i citoj edhe një herë: projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të diskutojmë fillimisht atë për sektorin energjetik?

Zoti zëvendësministër, do të flisni fillimisht ju dhe pastaj për konviktet, apo janë të dyja njësoj?

Mimi Kodheli – Fillojmë, atëherë, me diskutimin e projektligjit të parë “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi. Projektligji ka ardhur me procedurë të përshpejtuar. Relator kemi kolegun Beci.

Për të folur për projektligjin mirëpresim kolegun Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Mirë se vini, Profesor Bejtja!

Gjithashtu, prezentë nga kjo ministri kemi zonjën Karakaçi, drejtoreshë e Përgjithshme... Është zonja? Nuk është zonja.

Kemi zonjën Malile, drejtoreshë në OSHEE... Jam saktë?

Zonja Malile, jeni prezente?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se keni ardhur!

Kemi, gjithashtu, zonjën Halili, drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkëpunimit të Ndihmës së Huaj pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se vini, zonja Halili!

Të ftuar kemi, gjithashtu, zonjën Mitrovica, të cilën nuk e shikoj. Do të thotë që nuk është.

Ndërkohë, zotëria prezent është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prezantohuni. Cili jeni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtor i Projekteve në Ministrinë e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Energjisë? Shumë bukur!

Mirë se vini, zotëri!

Pa humbur kohë, profesor Bejtja, dy fjalë për marrëveshjen.

Fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, juve do të flisni për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, le të flasë fillimisht përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, zonja Halili.

Kesjana Halili – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit!

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin nëpërmjet mbështetjes buxhetore në shumën 50 milionë euro, e lidhur me reformat e ndërmarra në sektorin energjetik në Shqipëri.

Kjo marrëveshje vjen në përputhje me angazhimet e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim financiar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, KfW-së, AFD të nënshkruara në vitin 2018, si dhe në vijim të angazhimit të qeverisë shqiptare për reformimin e të gjithë sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Synimi i këtij programi është përmirësimi i sektorit në disa drejtime të tilla, si strukturore, operacionale dhe financiare. Ky program bashkëfinancohet nga qeveria gjermane nëpërmjet KfW-së, me të cilën aktualisht është lidhur dhe është dizbursuar gjatë vitit 2021 mbështetja buxhetore në shumën 100 milionë euro.

Zbatimi i programit të reformimit të sektorit të energjetik ka qenë një parakusht për marrjen e kësaj mbështetje buxhetore nga Agjencia Franceze për Zhvillim. Sikurse u përmend më lart, referuar edhe memorandumit të miratuar në vitin 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka zbatuar një plan strategjik me një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Europian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm.

Dua të theksoj se mbulimi i nevojave për financim nëpërmjet mbështetjeve buxhetore është një ndër instrumentet më të favorshme të financimit, duke qenë se kemi të bëjmë me kredi me terma të butë dhe të akorduar nga institucionet ndërkombëtare, si Banka e Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane për Zhvillim, KfW-ja, dhe Agjencia Franceze për Zhvillim, si dhe vetë Bashkimi Europian. Këto institucione

mbështesin zhvillimin e vendeve të ndryshme, ndër të cilat edhe vendi ynë. Për rrjedhojë, financimi i akorduar nga këta partnerë të rëndësishëm jo vetëm që jepet me terma më të favorshëm se kushtet e tregut, por mundësojnë, gjithashtu suport për realizimin e reformave të ndryshme dhe të rëndësishme për zhvillimin vendit, sikurse është edhe reforma e energjisë që përbën edhe bazën mbi të cilën do të akordohet kjo kredi që po diskutojmë sot. Mund të përmend disa nga mbështetjet buxhetore të akorduara gjatë vitit 2021: është mbështetja buxhetore e Bankës Botërore në vlerën 80 milionë dollarë, e cila u akordua për politikën për zhvillimin e qëndrueshmërisë dhe rritjes fiskale dhe mbështetja buxhetore e dhënë nga Bashkimi Europian në vlerën 180 milionë euro për asistencën makro-fiskale, si dhe mbështetja buxhetore nga KfW-ja, e cila e thashë që është një bashkëfinancim me këtë mbështetje buxhetore të AFD-së. Termat financiarë të kësaj huaje janë shuma 50 mijë euro, interesi është Euribor 6-mujor +1,35%, ka një komision angazhimi prej 0,25% në vit dhe një maturitet 12 vjet. Pra, këta janë termat kryesorë financiarë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Zëvendësministër, fjala për ju.

Ilir Bejtja – Përhëndetje të gjithëve dhe një vit i mbarë!

Ashtu siç e tha edhe drejtoresha, ne e kemi mbyllur tashmë tërësisht reformën e sistemit elektroenergjitik shqiptar, që ka qenë një program i miratuar me vendim qeverie nr. 742, datë 14 dhjetor 2018, dhe parashikon 18 komponentë për t'u përmbushur. Tashmë të gjithë këta janë të përmbushur, të certifikuar edhe nga Komiteti i Energjisë nëpërmjet një deklarate zyrtare nga ana e sekretarit të Komitetit të Energjisë në faqen e tyre, por edhe në një raport konceptual të lëshuar për certifikimin e këtij procesi zyrtarisht nga ana e tyre, një raport, i cili nuk mbaron me mbylljen e reformës, por presupozon vazhdimësinë e saj, funksionalitetin e të gjitha hapave të ndërmarrë dhe të garantojë edhe ato që kërkohen nga legjislacioni ynë dhe nga ligji bazë i sektorit, instalimi i modelit të ri të tregut, i cili kërkon, siç u tha, edhe akses të barabartë dhe të drejta pa diskriminim për të gjithë operatorët në të gjitha nivelet në prodhim, në transmetim, në shpërndarje dhe në furnizimin e konsumatorëve.

Me këtë ne përmbyllem një proces relativisht të gjatë, ambicioz; jemi të parët në vendet e Ballkanit Perëndimor që e përmbyllem një reformë të tillë, duke përfshirë këtu edhe vende anëtare, siç është Kroacia dhe Sllovenia, të cilat kanë akoma hapa për të ndërmarrë për kompletimin e krejt reformës, ashtu siç e kërkon paketa e tretë e energjisë, e cila është mbyllur në vitin 2020 në total si detyrim zbatimi. Tashmë ne kemi detyrime të reja, të cilat lidhen me procesin e dekarbonizimit, i cili është miratuar më 30 nëntor “*roadmap to decarbonisation*”, ku ne kemi procese të tjera për të ndërmarrë, të cilat lidhen me

përmirësimin e legjislacionit në lidhje me targetet kombëtare që kemi për procesin e dekarbonizimit. Për këtë ne kemi miratuar tashmë Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, i cili gjatë gjithë vitit 2022 do të rishikohet në frymën e politikave të reja qeverisëse të Komitetit të Energjisë, të cilat do të reflektojnë edhe një paketë zbutëse, që kërkojnë edhe në rang rajonal, pra për të gjithë Ballkanin Perëndimor, masa zbutëse të efekteve që mund të ketë kjo reformë në lidhje me dekarbonizimin për një mjedis më të mirë. Në këtë aspekt, partnerët tanë na kanë garantuar që bashkë me përmbylljen e reformës ne të kemi mbështetje të tjera jo vetëm buxhetore, por edhe sektoriale për vazhdimin e procesit njësoj si të gjitha vendet e tjera palë kontraktore të Komitetit të Energjisë.

Nëse keni pyetje për reformën...

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bejtja!

Kolegu Beci, keni fjalën si relator.

Benet Beci – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Nuk ngelet shumë për të thënë pas përshkrimit të mirë që bënë drejtoresha Halili dhe zoti Bejtja. Ajo që dua të rinëvizoj është se projektligji është në përputhje me angazhimin e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim financiar ndërmjet Shqipërisë, Francës dhe Gjermanisë në lidhje me programin “Mbështetja e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, nënshkruar që në vitin 2018. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ADF-ja dhe KfW-ja, bazuar në memorandumimin e mirëkuptimit, po implementojnë një plan strategjik, ashtu siç e përshkoi dhe zoti Bejtja, për reformim e sektorit energjetik në Shqipëri dhe ky planstrategjik përmban një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Europian, i cili bazohet në çmimet konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparentë, jodiskriminues dhe të qëndrueshëm.

Termat e huas janë që ato që u thanë, është një hua e butë, me një vlerë prej 50 milionë eurosh me interes Euroribor 6 muaj +1,35% dhe me një periudhë për pagesën e principalit prej 3 vjetësh. Vlen të theksohet se zbatimi i këtij projekti në këtë fazë nuk do të ketë efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit. Kështu që, për sa më sipër, dhe duke mbajtur në konsideratë rëndësinë që ka sektori energjetik, ju ftoj ta votojmë dhe ta mbështesim këtë projektligj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Beci!

Kalojmë në pyetje e diskutime.

Përfitoj nga rasti, meqenëse ka marrë fjalën, t'i kërkoj drejtoreshës Halili një sqarim më shumë për kolegët dhe për publikun: çfarë përfaqëson komisioni i angazhimit dhe çfarë përfaqëson tarifa e menaxhimit?

Kush ka pyetje ose komente të tjera?

Urdhëroni, zoti Dule!

Vagjel Dule – Duke i falënderuar zotin zëvendësministër dhe bashkëpunëtorët e tij, do të dëshiroja të bëja një pyetje, me kërkesën që të mos ma konsideroni si abuzim më tepër, por si përfitim nga prania juaj. Jemi në kushtet e një krize energjetike, e cila përditë e më tepër reflektohet në jetën e familjeve. I shikojmë rritjet e çmimeve në të gjitha drejtimet dhe pyetja ime ka të bëjë me këtë fakt: a mendoni që të merrni masa, së pari, për mosreflektimin e drejtpërdrejtë në faturat e energjisë elektrike të qytetarëve, dhe, së dyti, në reflektimin indirekt në çmimet e shumë mallrave dhe shërbimeve, të cilat rëndojnë shumë dhe reduktojnë në mënyrë të qenësishme fuqinë blerëse të qytetarëve?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje apo komente të tjera, fjala për ju, zonja drejtoreshë, dhe më pas zëvendësministri.

Kesjana Halili – Në lidhje me pyetjen për sa i përket komisionit të angazhimit dhe tarifës së menaxhimit, janë dy komisione të lidhura me kredinë dhe, në rast se kjo kredi nuk arrin të dizbursohet në momentin e caktuar, ne jemi të detyruar t'i paguajmë këto penaltete, pra këto interesa të komisioneve. Pra, janë të lidhura në elemente të kredisë së marrë, të cilat janë detyrime për shtetin tonë për t'i paguar, edhe në rast se nuk arrijmë të marrim dizburimin e fondeve, ato paguhen në vazhdimësi. Interesat fillojnë të paguhen pas 3 vjetësh, sikurse është përcaktuar këtu që periudha pa pagese principate është 3 vjet. Ndërkohë që po këto komisione jemi të detyruar t'i paguajmë që në momentin e lidhjes së marrëveshjes.

Mimi Kodheli – Pra, nuk varet nga performanca, thjesht jeni të detyruar t'i paguani që në fillim.

Zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Për pyetjen e zotit Dule, ne i kemi të gjitha masat që të mos kemi ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatorët fundorë familjarë dhe tek ata që janë të lidhur me tensionin e ulët, që kryesisht janë biznesi i vogël, por jo vetëm biznesi i vogël, ka spitale, mullinj për të bluar; varet nga zgjedhja që ato kanë bërë për t'u lidhur në rrjet. Flas për jofamiljarët, ndërsa familjarët të gjithë janë të lidhur me tension të ulët. Të gjithë ata që

lidhen me rrjetin me tension të ulët, do të vazhdojnë të kenë të njëjtën tarifë, pavarësisht problemeve që ka sektori energjetik në total, që nuk vijnë nga Shqipëria, por që lidhen me rritjen e çmimeve në tregun ndërkombëtar. Ka disa elemente që kanë ndikuar këtë rritje.

Së pari, është vërtetuar që rreth 95% e energjisë në tregun botëror prodhohet nga fosilet, kryesisht nga qymyri, nga gazi dhe çmimi i gazit, kohët e fundit është rritur deri 3 herë, në raport me çfarë ka qenë më përpara, që ka sjellë edhe një rritje të energjisë elektrike.

E dyta, është mbyllja e shumë centraleve prodhues ndotëse, kryesisht të bazuar në linjite apo qymyre të varfra, të cilat janë në një numër shumë të konsiderueshëm, në të gjithë Europën janë mbi 100 të tilla. Kjo nuk do të thotë se nuk ka energji, por është prodhuar harta e simetrisë midis prodhuesve dhe konsumatorëve. Sot është më e vështirë të shkosh ta gjesh të njëjtin burim energjie që ke gjetur deri dje, aq sa në dijeninë, informacionin tonë, tregtarët sjellin energjinë me 2-3 kufij, që do të thotë se edhe kapacitetet e transmetimit janë akoma më të larta.

E treta, është futur taksa e karbonit, nga 1 prilli i vitit 2021 të gjitha vendet, që bazojnë prodhimin e tyre të energjisë në konsumin e përdorimit të fosileve, paguajnë një taksë karboni, që në fillimet e saj ka qenë rreth 20 euro për megavat, tani ka shkuar mbi 72 euro për megavat. Kjo ka sjellë probleme, pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përjashtuar Maqedoninë dhe Serbinë. Të gjitha janë të bazuara kryesisht në burime hidro dhe duhet ta importojnë energjinë. Janë dëmtuar në këtë rast edhe Bosnja bashkë me Maqedoninë, që kanë pasur centrale automike me qymyre shumë të varfra ose me naftë, të vjetra në teknologji; janë mbyllur, është mbyllur centrali i Oslomeas me kapacitet 240 mega, është shumë i rëndësishëm. Në Maqedoni aktualisht ndërpritet energjia për arsye efieience, sepse nuk duan të kenë ndikim shumë të lartë nga çmimet e importit. Në Bosnjë po bëjnë çmos që ta mbajnë gjallë akoma pjesën e centralit, por që ky nuk do të zgjasë me tepër se sa viti që vjen, që do të thotë se kjo krizë për Ballkan nuk është mbaron nesër, por do të vazhdojë për një periudhë relativisht; parashikohet 2-3 vjet, për sa kohë që të bëhet një rialokim i lidhjeve midis prodhueseve të energjisë elektrike me tregtarët dhe me përdoruesit. Kemi pasur pak ndikim edhe nga Kosova; prej nëntorit kanë pasur probleme në “Kosova B” në 3 turbinat. Në dijeninë tonë, e kanë vënë në punë një tërë turbinë dhe pritët shumë shpejt të vihet edhe turbina tjetër, që do të thotë se edhe kërkesa nga Kosova do të jetë më e ulët për energji elektrike në treg. Ne presim të mos kemi ndikime shumë të mëdha nga importi duke arritur të menaxhojmë shumë më mirë apo më me kujdes të gjithë energjinë që kemi në kaskadën e Drinit. Shpresojmë të jetë një vit i mirë, edhe për ne do të jetë, nëse prodhohen të paktën në 4 të tjera dhe të kemi mundësi të shesim tani apo të alokojmë në formë depozitimi

ose optimizimi energjinë, në mënyrë që të kemi mjaftueshëm para ose energji për të marrë, atëherë kur ne importojmë që është 6-mujori i dytë i vitit. Kemi marrë edhe masa të tjera që lidhen me burimet e rinovueshme, me diversifikimin e tyre. Presim që për 15 muaj të futen në treg me kapacitet të plotë, 240 mega instalim i energjisë së diellit, fotovoltaike, të cilët prodhojnë që të gjithë në orare pikë, që do të thotë se jemi shumë të favorizuar nga kjo; jemi të favorizuar edhe për faktin se kemi një rezervë të mjaftueshme ujore për t'i përballuar të gjitha disbalancat që mund të krijohen nga burimet e rinovueshme, të cilat nuk janë gjithmonë të qëndrueshme. Radiacioni nuk është i njëjtë kur i bie panelit të diellit direkt apo kur moti është me re. Pra, për këtë arsye edhe luhatjet përballohen nëpërmjet kaskadës që kemi, si rezervë dytësore.

Nga ana tjetër, kemi hapur edhe një proces, i cili mbaron brenda 18 muajsh, për instalimin e një kapaciteti prej 150 megash, për ferma eolike, energji e erës; janë duke u bërë studimet, matjet dhe presim brenda 8 muajve të kemi rezultatet e para të potencialit energjetik që kanë vendet, ku mendohet të ketë instalime të mullinjve të erës për prodhimin e energjisë. Jemi duke menduar edhe për një projekt të ri, i cili lidhet me akumulatorët e energjisë që do të sjellin një menaxhim më të mirë të burimeve jo të balancuara të energjisë. Në mënyrë do të përdorim më mirë kaskadën e Drinit, por vëmë në punë 2 centrale të lëvizshme, të cilat janë të bazuara në LG, një 60 mega dhe një 54 mega; fillimi i punës, prodhimi i tyre është parashikuar për më 1 maj, pra do të kemi 114 mega prodhim. Brenda 15 muajve të kemi rikomisionimin total dhe vënien në punë të TEC-it të Vlorës deri në 250 mega, fuqi të instaluar që e kthen të gjithë këtë situatë, që duket e pamundur për vendet e Ballkanit, për Shqipërinë një rast suksesi dhe t'i ndihmojmë edhe fqinjët tanë, duke filluar nga Greqia, zona e Kozanës-Siatista; Maqedonia, zona e Maqedonisë Perëndimore dhe pjesa e Kosovës, që për ne janë fitime direkte, por, duke qenë se kapacitetet tejkalojnë nevojën tonë të 6-mujorit të dytë, kemi mundësi të ndihmojmë të gjithë rrjetin rajonal me energji.

E thashë edhe një herë, tensioni i ulët që janë 4,7 terravat, janë që të gjithë për të mbrojtur për tarifën, pra edhe bizneset që e kanë 14 lekë, edhe popullsia që e ka 9,5 lekë. I kemi llogaritur të gjitha mundësitë tona për të ndihmuar edhe biznesin e mesëm që të mos ndikohet në mënyrë të rëndë nga çmimet e importit; çmimi i tyre të dalë jo vetëm për shkak të bursave rajonale, por që ato të mos tejkalojnë 20 lekë, çmim i liberalizuar, por shumë më i ulët sesa është sot. Tani në këtë moment që flasim në tregun ndërkombëtar, për shembull 287 euro është në bandë energjia, në pikë shkon rreth 370.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për të gjithë panoramën më shumë sesa shteruese të situatës energjetike jo vetëm në Shqipëri, por në rajon dhe më gjerë!

E vlerësoj profesionalizmin tuaj personalisht!

Ju falënderoj për këtë gjë!

Ka një pyetje nënkryetari, zoti Alizoti. Pastaj kolegu Çollaku.

Tomor Alizoti – Po dal direkt në thelb. Energjia në Shqipëri ka qenë gjithë kohës, për një kohë të gjatë problemi kryesor. Përveçse është problem kryesor, është edhe problem tmerrësisht abuziv, brenda është edhe korruptiv, sepse bëhet fjalë për financa shumë të mëdha dhe në 30 vjet, nuk po hyj në kohën e diktaturës, ende ka zona në Shqipëri, po diskutoj si një joekspert, por si një konsumator i energjisë, si gjithë të tjerët, që kanë probleme me energjinë. Çdo hua, çdo borxh, që merr shteti shqiptar, është një shenjë e keqe për shtetin shqiptar, pavarësisht se mund të jetë e domosdoshme. Pyetja ime është: ky borxh që do të merret, pa hyrë në teknika, ku konkretisht do të vihet në përdorim?

E dyta, sa shfrytëzohen prodhuesit vendas? Se ka edhe prodhues vendas, të cilët prodhojnë energji, sado e vogël, a merret i gjithë prodhimi energjetik i tyre? Anashkalohen edhe ata në çmim, se këtu është sensi problematik që mund të jetë abuziv? Kam informacion që disa anashkalohen dhe çmimet ngrihen apo ulen qëllimisht që të abuzohet me një pjesë. Në fund të gjithë kësaj, personi ose individi që vuan është konsumatori. Kjo hua që u mor, ky zhvillim teknik që do të ndodhë, sa ndikon te konsumatori? Çfarë përfiton konsumatori ndryshe sot pa huan dhe nesër në përdorimin e borxhit, 50-60 milionë euro? Çfarë përfiton konsumatori direkt? Po flas për qytetarin, por edhe për atë që merret me biznes.

Pra, dua të di konkretisht sa shfrytëzohet burimi vendas dhe çfarë përfiton konsumatori direkt, qytetari dhe biznesi? Por ne, meqenëse jemi një pjesë e madhe qytetarë, atëherë ku e ndiejmë ndryshimin ne apo thjesht do të paguajmë kaq sa kemi paguar, apo do të kemi energji më cilësore? Këtë nuk mund ta them dot se kërkon ekspert? Unë kërkoj përgjigje për të gjitha këto pika që ju thashë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Të lutem, Kreshnik!

Kreshnik Çollaku – Dua t'ju them se nuk jam ekspert i fushës dhe nuk pretendoj të bëj asnjë lloj vlerësimi të natyrës teknike, por ajo çfarë më bëri përshtypje nga përgjigjet tuaja për kolegët paraprakisht ishte fakti që bëtë një trajtim të logjikës ekonomike të funksionimit, të prodhimit, të ndërvarësisë dhe të bashkërendimit me vendet fqinje dhe për këtë dua të vë theksin, pasi kjo krizë energjetike, në fakt, me aq sa duket krizat energjetike, nuk është vetëm çështje ekonomike, por edhe çështje politikash dhe çështje strategjish politikash në të gjithë kontinentin, por edhe në botë.

Pra, nga kjo pikëpamje, në rast se do të kishte logjikë pyetja do të isha edhe për një nxitje, sidomos për hapësirën tonë Ballkanike, për një bashkëpunim më të afërt me Kosovën, nuk e di nga pikëpamja teknike se nuk jam ekspert, por duke u nisur nga nevoja e një sigurie strategjike në çështjet e energjisë ne e kemi shumë të nevojshme, sidomos në këto situata, të bashkërendojmë politikën tonë me Kosovën me resurset që ata kanë me resurset që ne mund kemi mbase edhe me një lloj sigurie energjetike që ne mund t'i ofrojmë kësaj hapësire shqiptare, patjetër duke vënë në balancë logjikën ekonomike, por duke mos mbetur dhe kufizuar veten sa i takon kësaj logjike në këtë drejtim.

Ka disa çështje, të cilat janë të sigurisë ekonomike të rajonit, të hapësirës shqiptare Shqipëri-Kosovë ku logjika politiko-strategjike duhet konsideruar me më shumë prioritet ose ndoshta edhe po aq prioritare sa ajo ekonomike. Nga kjo pikëpamje më duhet t'ju pyes: a ka ndonjë përpjekje për një bashkërendim jo vetëm momental, sipas nevojave, por një projektim afatgjatë, pse jo edhe një unifikim të sistemit midis dy vendeve për të garantuar këtë lloj mikropavarësie energjetike, e cila do të ishte strategjikisht dhe politikisht shumë e vlefshme për këto çaste që po kalon kontinenti me këto përballje të mëdha?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Zëvendësministër.

Ilir Bejtja – Për përdorimin e kredisë, më duhet t'ju them se kredia nuk përdoret për energjinë elektrike, pra për sistemin elektro-energjetik, është mbështetje buxhetore. Ne jemi kusht precedent në kontratë, pra të realizohet reforma dhe më pas të arrijmë ta marrim si mbështetje buxhetore. Ka qenë sfidë jona që ne ta garantojmë këtë mbështetje dhe kuptohet që përfitimet janë të dyanshme. Ne përmbyllëm reformën, t'ju them të drejtën kishte edhe ajo vonesat e veta dhe arsyet kanë qenë nga më të ndryshmet, duke filluar nga zgjidhjet gjithmonë të dyshimta se si do t'ia dalim për të mbajtur në këmbë dhe për të garantuar energjinë me çmimet që ne kemi pasur që nga viti 2015. Jemi i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që nuk i ka ndryshuar çmimet, duke pasur parasysh që përfitimet janë përdorur për të shlyer detyrimet e prapambetura.

Kur ne e kemi marrë CEZ-in nga kompania çeke që e kishte në vitin 2013, kemi pasur 780 milionë euro ekuiti negative, mbi 1 160 000 000 debite të prapambetura dhe të paarkëtuara dhe për konsumatorët, flas për ata që kishin mbi 1 vit pa paguar, sistemi pothuajse kishte dështuar. Në dhjetor të vitit 2013 kishim 50% humbje dhe 48% pagesë të faturës korente. Programi ishte shumë ambicioz dhe për këtë proces kemi qenë të asistuar nga Banka Botërore, ka qenë një program i rimëkëmbjes financiare, i cili me mbështetjen e

qeverisë dhe masat e forta, pra me përmirësimet që iu bënë Kodit Penal për konsideratat e vjedhjes ose të abuzimit me energjinë, përmirësimet që i bëmë sistemit për ndërprerjen e energjisë për ata që nuk e paguanin, mbështetja që u dha nga Banka Botërore për të gjithë sistemin, 150 milionë euro kredi, 26 për OST-në, 30 për sigurinë e furnizimit për shkak të ndikimit nga moti në prodhimin e KESH-it dhe 90 milionë për projekte rehabilituese në sistemin e shpërndarjes. Kjo ishte një frymëmarrje në vitin 2014 dhe më tej në vazhdimin e reformës për të gjithë vitet në vazhdim.

Në dhjetor të vitit 2018 ne kemi paraqitur një program tjetër, programi i konsolidimit të situatës financiare të sistemit elektro-energjetik, përsëri me Bankën Botërore dhe ndryshuam të gjitha targetet, të cilat tashmë ishin të arritura, pra ato që ishin targete të vitit 2019 ishin të arritura. Kuptohet që kemi qenë shumë keq dhe në fillim arritjet ishin shumë të lehta, ndërsa tani nuk është e njëjta situatë, sepse tani për 1% ulje të humbjeve kërkohen rreth 12-13 milionë dollarë investime. Pra, në këtë aspekt tani jemi në kushte shumë më të mira dhe më të favorshme.

Një tregues tjetër performance ishte edhe fakti që në vitin 2013 CEZ-i e mbylli me rreth 28 miliardë lekë të ardhura, ndërsa sot të ardhurat e OSHEE-së për këtë vit janë 72 miliardë lekë. Pra, i gjithë sistemi funksionon, por defekti që kemi pasur këtë vit nuk ka qenë prodhimi i energjisë elektrike, por çmenduria e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat në shtator kaluan në rreth 162 euro megavati mesatarja për të përfunduar në dhjetor me rreth 270-280 euro mesatarja, pra pikë dhe jo pikë, kjo për pjesën se si ka ndryshuar si performancë.

Kemi tregues që lidhen me sigurinë e furnizimit, e cila është një e mirë publike dhe këtë ne e kemi garantuar plotësisht gjatë gjithë këtyre viteve, por nuk mund t'ju them që kemi garantuar plotësisht cilësinë e furnizimit ku rast pas rasti kemi pasur edhe probleme, të cilat me kalimin e kohës nëpërmjet ndërhyrjeve në rrjet, pastrimeve për abuzimin apo investimeve për t'i kaluar të gjitha në sistemin e ri 1102004 me ABC në të cilën nuk është e mundur të ketë ndërhyrje, si dhe humbjet nga 20 dhe 43% që ne i kemi aty ku ndërhyjmë shkojnë jo më shumë se 4% ka sjellë përmirësime.

Nuk është e mbyllur e gjithë Shqipëria në lidhje me cilësinë e furnizimit, pasi ka shumë zona rurale, të cilat vazhdojnë të kenë probleme lidhur me cilësinë, me nivelin e tensionit që ju shkon për pajisjet e tyre që ata t'i përdorin, por ama nuk ka absolutisht pamundësi furnizimi me energji elektrike. Shpejtësia jonë e reagimit ndaj defekteve, jo ndërhyrjet e planifikuara, është jo më e gjatë se 38 minuta në nivel kombëtar, kryesisht defektet janë atje ku ne nuk kemi ndërhyrë ende në rrjetin e shpërndarjes, pasi vazhdojnë të

jenë me tela ajrorë, kalojnë nëpër zona ku rrjeti bie shumë shpejt në fazë-tokë për shkak të erës dhe të pyjeve, pra janë vende ku ne duhet të vazhdojmë programin tonë të ndërhyrjes.

Me Bankën Botërore, për shkak të ruajtjes së stabilitetit financiar të OSHEE Grup kemi stabilizuar, sipas vendimit të qeverisë që ju thashë për konsolidimin, një total investimesh prej 77,5 milionë euro në vit jo më shumë, megjithatë ne e kemi tejkaluar këtë çdo vit, sepse kemi pasur mbi 120 milionë euro investime. Ka pasur raste ku për shkak të ndryshimit të raporteve midis importit dhe prodhimit të brendshëm t'i ndalojmë investimet për një farë periudhe për t'i rimarrë ato në momentet ku kemi mjaftueshëm energji në vend.

Lidhur me prodhuesit vendas.

Më duhet t'ju them se të gjithë prodhuesit vendas e shesin energjinë në Shqipëri, përjashto prodhuesit e mëdhenj që janë IN Energji dhe ShtatCraft, të cilët jo gjithmonë marrin pjesë në tregun vendas, sepse kanë mjaftueshëm kapacitete për të dalë me energjinë e tyre edhe në tregun ndërkombëtar, pra shesin atje ku është më shtrenjtë. Ndërkohë që prodhuesit e vegjël ose prodhuesit privatë të energjisë elektrike, prodhuesit e pavarur e shesin energjinë te OSHEE Group në platformën e FTL-së, e cila shkon për mbulimin e humbjeve të energjisë në rrjetet që ne kemi, është rreth 1,4 teravat, dhe një pjesë e saj nëse ka prodhim të mjaftueshëm shkon për mbulimin e nevojave të furnizuesit të mundësisë së fundit ose të furnizuesit universal, siç i themi ne.

Një pjesë e energjisë shpesh optimizohet, pra prodhimi ynë vendas dhe jo i prodhuesve të vegjël, sepse të optimizosh duhet të kesh rezervë hidrike. KESH-i e ka këtë mundësi për ta bërë, që do të thotë se shesin në orën e pikut dhe blejnë në jo pik për të mbajtur në nivel kaskadën që të kemi mundësi ta përdorim atë sa më gjatë si rezervë ujore gjatë momenteve që ne nuk kemi më reshje.

Në çmim ato kanë të gjithë çmim të njëjtë e kanë me kontratë...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, kanë kontratë me ne, çmimi i tyre është vendosur që në vitin 2016 me ligjin "Për energjitë e rinovueshme" dhe në nenin 22 thuhet: "Çmimi i tyre është 1,22 herë krahasuar me çmimin e bursës Upeks, jo më pak se 7,48 lekë dhe jo më shumë 8,5 lekë".

Pra, kjo është formula që është rënë dakord me ata, sepse atëherë kur kemi bërë ligjin, janë bërë dëgjuesat, ka pasur një tendencë që ne t'u japim atyre çmim tregu, por nuk kanë pranuar. Deri para se të fillonte kjo histori ata kanë qenë përfitues nëpërmjet çmimit që marrin, ndërsa tani që po flasim ndoshta të gjithëve ju vjen mbarë që të mos na e shesin më ne energjinë, por ta shesin kur t'ju dojë qejfi, por këtu bëjmë fjalë për prodhuesit që nuk kanë as struktura të organizuara që të mund ta shesin energjinë të pavarur në tregun e lirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kujt? I prodhuesve të vegjël?

Vitin që shkoi shifrat kanë qenë diku të rreth 6 terra/vat, një vit më parë 5,8 terra. Ka qenë vit shumë i vështirë viti 2020, sepse edhe konsumi ka qenë shumë i rritur për shkak të pandemisë, sepse të gjithë njerëzit rrinin në shtëpi dhe u rrit shumë konsumi familjar, i cili, për hir të së vërtetës, është i subvencionuar. Kostoja mesatare, çmimi i miratuar nga Enti Rregullator për Energjinë në furnizim është 10,73 lekë. Ne ua shesim konsumatorëve me 9,5, ndërkohë që është më i lartë çmimi i jofamiljarëve, dhe ato kompensohen që të dalin në nivelet e 10,73. I kemi tejkualuar rezultatet, që kanë qenë bazë për llogaritjen e tarifës. Të ardhurat, mbledhja e të ardhurave nga shitja e energjisë ka qenë e planifikuar 87,3%, ne sot e kemi mbi 92% në rang kombëtar dhe humbjet financiare kanë qenë të parashikuara 12,7%, që ne sot i kemi rreth 6-7%. Pra, e kemi ulur jashtë mase debinë e re që të mund të krijohet. Në këtë debi ato që ndikojnë më shumë janë ujësjellësit. Një pjesë e mirë e tyre, nga një analiza që ne kemi bërë para dy vjetësh, nuk e kanë energjinë as në kosto. 37 ujësjellës në vend nuk e kanë të parashikuar energjinë në kosto. E shohin si një subvencion që duhet t'ia bëjë qeveria. Është e përfshirë brenda humbjes financiare të parashikuar, por, po të ishte mundësia që t'i paguanin ato të gjitha, do të kishim shumë më tepër lirshmëri dhe nuk do të kishim nevojë të ndihmoheshim nga buxheti i shtetit. Borxhi i tanishëm i ujësjellësve bashkë me interesat dhe penalltitë është diku të rreth 27 miliardë lekë në total, i maturuar që nga viti 2014.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ilir Bejtja - Nuk i kam dhënë përgjigje një pyetjeje të fundit, që ka të bëjë me marrëdhëniet me Kosovën.

Mimi Kodheli – Po.

Ilir Bejtja – Kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi marrëdhënie me Kosovën, por me ata është teoria e avantazhit krahasues, jo e avantazhit absolut, sepse ata kanë çmime gjithmonë më të shtrenjta se në. Neve prodhojmë energji nga kaskada më të lirë se ata, dhe në çdolloj rasti janë ata përfitues të parë kurse ne përfitojmë vetëm nëpërmjet orëve pik dhe orëve jopik.

Mimi Kodheli- Faleminderit, zëvendësministër!

Do t'u kujtoja kolegëve deputetë se, përtej interesit që ngjall kjo temë sensitive për të gjithë ne dhe qytetarët e Shqipërisë, ky është një komision për dhënie mendimi, ku ne shikojmë sesi ratifikimi i kësaj marrëveshjeje përputhet me të gjitha marrëveshjet që janë në fuqi mes Republikës së Shqipërisë dhe vendeve respektive ose organizmave respektive. Pra,

ky është qëllimi ynë primar kryesor, ndaj edhe këto marrëveshje kalojnë në Komisionin e Politikës së Jashtme.

Kështu që, nëse ne herë tjetër do të kemi ekzigjenca, për të pasur njohuri më të thella dhe sqarime më të plota lidhur me problematika të caktuara, por sidomos ato që cekin problemet e energjisë, zëvendësministri i nderuar dhe të gjithë bashkëpunëtorët raportojnë në komisionin përgjegjës, që në këtë rast është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, dhe mund të jenë atje prezent për të marrë informacione më të gjëra lidhur me çështje të caktuara.

Kalojmë në votim. Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim? 2 abstenime.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? 2 abstenime.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? 2 abstenime.

Miratohet.

Votimi në tërësi i projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim? 2 abstenime.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.01.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe (KfW) për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Bardhyl Kollçaku, Tomorr Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku, Benet Beci dhe Vangjel Dule.

Mungojnë:

Alqi Bllako, Tritan Shehu, Grida Duma dhe Shpëtim Idrizi.

Të ftuar:

Ilir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Kesjana Halili - Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj

Ardian Islami – përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe (KfW) për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Ajazi. Të ftuarit për këtë pikë janë po të njëjtët, por besoj se zonja Halili sqaron për projektligjin, sqaron marrëveshjen.

Fjala për ju.

Kesjana Halili – Faleminderit!

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri nëpërmjet një kredie në shumën 20 milionë euro.

Fillimisht më lejoni t’ju kujtoj se bashkëpunimi zhvillimor shqiptaro-gjerman fokusohet në energjinë, furnizimin me ujë të pijshëm, menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbajtjeve, si dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe të pajtueshëm social.

Në këtë kuadër vlen të përmendet se prej fillimeve të bashkëpunimit me KfW-në janë angazhuar fonde të konsiderueshme në grante dhe kredi për vendin, duke e bërë një nga vendet më të rëndësishme të bashkëpunimit për Europën Juglindore. KfW-ja është veçanërisht aktive në sektorin e energjisë, në infrastrukturën komunale dhe në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Vlera e angazhuar nga KfW-ja për financimin e projekteve me anë të kredive ndër vite është në shumën 778 milionë euro ose 95 miliardë lekë, ku peshën më të madhe e zënë investimet në sektorin e energjisë në masën 39,6%, ose 308 milionë euro.

Kjo marrëveshje huaje që po diskutojmë sot është faza e katërt e financimit për programin për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri. Krahas këtij financimi me kredi, programi do të mbështetet edhe me financimin me grante nga KfW-ja në total në shumën rreth 15 milionë euro. Qëllimi i financimit me kredi, i cili u bashkohet granteve të akorduara deri tani, të cilat janë në shumën 9,43 milionë euro, është të kontribuojë në rehabilitimin e energjetik të 19 konvikteve në total dhe ndërtimin e 3 konvikteve të reja.

Me anë të realizmit të projektit, nga njëra anë, synohet që, nëpërmjet aplikimit të masave të eficiencës së energjisë, të kursehet ndjeshëm energjia në godinat e rehabilituara, dhe, nga ana tjetër, t’u sigurohen studentëve kushte jetese të përshtatshme. Institucionet zbatuese të këtij projekti janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila bashkëpunon

me Bashkinë e Tiranës, institucioni që ka në përgjegjësi administrative konviktet dhe me administratën e rezidencës studentore universitare nr.1, si përfituese e drejtpërdrejtë e këtij projekti.

Sa u përket termave financiare shuma është 20 mijë euro, interesi do të përcaktohej në momentin e disbursimit të kredisë dhe do të bazohet në normën e referencës plus 0,55 % një marzh fiks, tarifa e menaxhimit është 1% e shumës së huas, komisioni i angazhimit deri 0,25% në vit dhe maturiteti do të jetë 15 vjet në 5 vitet e para pa pagesë principali.

Mimi Kodheli - Drejtor fjala për ju.

Ardian Islami – Përshëndetje!

Më lejoni t'ju sqaroj më tej për projektin nga pikëpamja teknike. Aktualisht sot jemi mbledhur për t'ju informuar për fazën e katërt të projektit, me të cilën përmbylлим të gjitha alokimet e fondit për Qytetin Studenti. Më parë në këtë komision ne kemi prezantuar po ashtu edhe tri fazat e tjera: përkatësisht me 4,5 milionë euro, 2,9 milionë euro dhe 2 milionë euro. Po ashtu në këtë kredi alokohet edhe një fond grant prej 1 milion euro dhe ndërkohë nga KfW 4,7 milionë euro. Në total fondi shkon në 35 milionë euro për rehabilitimin e 19 godinave dhe ndërtimin e 3 godinave të reja. Specifikisht 3 godinat e reja, në termat e referencës që kemi diskutuar me KfW, mendohet të jenë më zero konsum energji, që është përvojë e re për vendin tonë, po ashtu edhe aplikimi në Qytetin Studenti.

Sa i përket akomodimit në total, kapaciteti total i akomodimit të studentëve në Qytetin Studenti është 5800 studentë, pas rehabilitimit do të akomodohen vetëm në projektin e KfW-së, që lidhen me 19 godina, 3200 studentë. Ndërkohë, ju informoj se 7 godina të tjera janë duke u rehabilituar nga buxheti i shtetit dhe një prej tyre është e rehabilituar nga TIKA. Kapaciteti i akomodimit të tyre është 1800 studentë. Pra, kemi një reduktim të numrit të studentëve domethënë nga 5800 shkon në 5000, kjo për shkak se respektohen edhe standardet, edhe kushtet e komfortit për studentët.

Rehabilitimi mendohet të jetë i thellë në terma teknike, që do të thotë se do të ketë ndërhyrje në anën strukturale të ndërtesave, duke verifikuar anën strukturale, dhe po ashtu do të ketë edhe modifikimet e mundshme nga pikëpamja strukturale, por do të ketë edhe në termat e eficiencës së energjisë, duke filluar nga ndërimi i dritareve, veshja e fasadës me anë të një shtrese termoizoluese, do të rehabilitohen edhe tarracat, duke përmirësuar kushtet e eficiencës, po ashtu, edhe sistemi teknik do të ketë ndërhyrje të thella dhe, sigurisht, do të implementohen sisteme me terma efience energjie më të lartë.

Nga diskutimet që kemi pasur me konsulentin, pasi ai është në fazën e përmbylljes së projektit të detajuar për 5 godinat e para, mendohet që të shkojmë në targetin 75%

kilovatë/orë për metër katror në vit nga kushtet aktuale, që gjenden ndërtesat, që është diku 190 kilovatë/orë për metër katror në vit.

Pak a shumë këto janë termat teknike. Nëse ju keni pyetje për më tej, jam sërish i gatshëm t'ju sqaroj.

Faleminderit!

Ilir Bejtja - E rëndësishme është të kuptohet që ne bëjmë ndërhyrjen sipas ligjit, sepse ndërhyhet mbi 25% të volumit të ndërtesës, në ato ndërtesa të cilat janë të vlerësuara “kalueshëm” nga pikëpamja strukturore, dhe nuk mjaftohemi vetëm me eficiencën energjetike, por me rritjen e komfortit të studentëve në jetesën e tyre në konvikte. Prandaj edhe reduktohet pak numri. Domethënë, rreth 1/3 shkon për pjesën e eficiencës, kapotime, izolime apo instalimi i prodhuesve të energjisë nëpër tarraca, përdorimi i bolierëve pa energji elektrike, por me fotovoltaike, me panele diellore e të tjera. Që të gjitha këto bëjnë të mundur që ne të rrisim eficiencën.

Nga ana tjetër, restaurimi është në themel, në çdo element të ndërtesës.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Fjala për relatorin.

Besion Ajazi – Si fillim doja t'ju uroja juve dhe kolegëve një sesion të mbarë parlamentar!

Pas një prezantimi të drejtoreshës, zëvendësministrit dhe drejtorit të projekteve, sigurisht më ngelet pak të shtoj, por gjithsesi dua të them se marrëveshje apo projektligje të tilla janë shumë të mirëpritur për mua, sepse kanë të bëjnë me arsimin, me studentët, kanë të bëjnë me të ardhmen intelektuale të këtij vendi. Pra, edhe përmirësimi i kushteve të këtyre studentëve është një gjë shumë e mirë edhe për të ardhmen, është edhe një reflektim apo reagim i qeverisë, edhe pas marrëveshjes apo paktit me studentët, për të përmirësuar kushtet e tyre. Sigurisht, unë e përshëndes këtë marrëveshje.

Në termat ekonomike dhe teknike foli drejtoresha dhe drejtori i projekteve, ndërsa unë do të doja të nënvizoja vetëm dy momente: kjo shumë e akorduar në formën e huas do të shërbejë vetëm për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, që është edhe faza e katërt përmbyllëse, një pjesë e huas do të përdoret për ndërtimin e disa godinave të reja nga masterplani i Qytetit Studenti. Për mua kjo është një gjë shumë e mirë.

Sigurisht, ashtu siç tha edhe drejtori, kanë pasur edhe tri faza të tjera, që kanë të bëjnë me të njëjtën objekt-investimi.

Në këto kushte, i ftoj kolegët e këtij komisioni ta miratojmë dhe të votojmë pro kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegut Ajazi!

Jemi të hapur për pyetje dhe diskutime. Kush e do fjalën, kolegë?

Zëvendësministër, më shumë se sa një pyetje, kam një kuriozitet timin. Unë besoj se, nëpërmjet këtij investimi shpresoj shumë që ka ndryshuar shumëçka në qasjen e studentëve lidhur me mbarëvajtjen e jetesës së tyre studentore, në momentin kur janë përfitues të ngrehinave të ndërtesave të Qytetit Studenti. Nuk kam asnjë eksperiencë shqiptare në këtë drejtim, por mendoj se kam eksperiencë të mjaftueshme jashtë për të kuptuar se ka shumë rregulla strikte në qytetet studentore, në përgjithësi, lidhur me konsumin e energjisë elektrike ,për shkak të mosabuzimit me të, të tipit lavaxantë të përbashkëta, orare të caktuara të përdorimit e të tjera. Ju e dini shumë më mirë se ne këtu, profanët e fushës, që atje ka fasha të ndryshme të orareve të konsumit. Pra, në qoftë se përdoret lavaxantia, le të themi, si një konsumatore e madhe e energjisë, pas mesnate, ka një tarifë tjetër, krahasuar me përdorimin gjatë ditës. Do të mbërrijmë ta bëjmë edhe ne këtë gjë siç duhet, apo ne ndërkohë e kemi bërë dhe unë nuk kam informacion?

Ky është më shumë një kuriozitet se sa një pyetje, që ka të bëjë me projekt-marrëveshjen.

Ilir Bejtja – Në zonën jofamiljare ne e aplikojmë këtë çdo ditë. Pra, ka tjetër çmim në orët pikë dhe tjetër çmim në orët jopikë. Pra, ka një shtesë çmimi, e cila arrihet ose nëpërmjet transformatorëve të rrymës, çmimi nga 11 lekë shkon 11,4 ose nëpërmjet shtesës së orës pikë që është 1,65 lekë për orët me intensitet të lartë, ose pa këtë 1,65-lekëshin, 14 lekë për biznesin e vogël dhe 11 lekë për biznesin, për tensionin e ulët dhe atë të mesëm.

Në dijeninë time është ndërmarrja e Qytetit Studenti, që është klienti ynë. Unë nuk di që studentët të paguajnë ndonjë tarifë të veçantë për energjinë, por paguajnë një tarifë komplekse për akomodimin e tyre, që është modeste.

Pra, ka një konkurrencë goxha të lartë midis studentëve për të zënë vende në këtë qytet, edhe në kushtet aktuale që flasim.

Përmirësimi i kushteve patjetër që do ta ndihmojë ndërmarrjen e Qytetit Studenti, ashtu siç tha edhe drejtori, të ulë jashtëzakonisht shumë, 75 kilovatë për metër katror energjinë e konsumuar deri tani, që për ata është një konsumim goxha i madh. Se si do ta përkthejnë ata për studentët në ulje tarifash apo në shtesë shërbimesh të tjera, unë nuk e kam këtë informacion. Ato janë pjesë e këtij projekti. Ne kemi një *Project Implementation Unit*,

ku 2/3 e kësaj njësie, janë nga ndërmarrja e Qytetit Studenti nga bashkia, pavarësisht se njësinë e zbatimit të projektit, e zbatojmë ne.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Bejtja, për të gjitha sqarimet!

Le të kalojmë në votim.

Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe (KFW) për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”? Kundër? Abstenim? Insistoj që të biem të gjithë dakord.

Miratohet projektligji me 100% të votave.

Faleminderit, kolegë, për bashkëpunimin!

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E konsideroj të mbyllur diskutimin për këtë projektligj.

Faleminderit, për bashkëpunimin, kolegë, zoti zëvendësministër, drejtorë dhe pa dyshim, kolegët e opozitës!

MBYLLET MBLEDHJA